



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:285069
Datë: 01.12.2023
Numri i dokumentit: 05001221

C – IV- 20 – 0052

Paditësi :

S H nga Obiliqi, e tani me banim në Prishtinë, e të cilin me autorizim e përfaqëson av.N Th nga Prishtina.

Kundër

Të paditurës :

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Lagjja, "Lakrishtë", Rr. "Driton Hoxha" nr.55, Prishtinë.

Për : Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, më dt.01.12.2023, mori këtë :

A K T V E N D I M

I. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), jep pëlqimin për tërheqjen e padisë së paditësit, S H nga Obiliqi e tani me banim në Prishtinë për kompensimin e 20 % në shumën prej 4,184.00 € si dhe kamatën ligjore prej 8 % e duke filluar nga data e nxjerrjes së Vendimit me dt.31.03.2015 e deri më tash nga Ndërmarrja Shoqërore, N.Sh,"I.M.F, Kosova" me seli në Prishtinë (në likuidim), dhe se padia e paditësit, në këtë çështje juridike kontestimore, **KONSTATOHET e tërhequr.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Paditësi, me dt.30.07.2020, përmes të autorizuarit të tij pranë DhPGJSK-së, ka parashtruar padi/ankesë për kompensimin e borxhit në vlerë prej 3,573 kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, PRN008 – 0102 të dt.31.03.2015 nga N.SH, "I.M.F Kosova", e me të cilën kërkesa e tij për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën prej 04.09.1990 deri më 01.09.1999 në shumën prej 17,264.94 euro nga Ndërmarrja Shoqërore, NSh,"I.M.F Kosova", në Likuidim, është pranuar në shumën prej 16,091.23 Euro për pagat e papaguara dhe në shumën prej 2,036.96 € për tatim në të ardhura personale derisa paditësi me këtë padi kërkon nga gjykata t'i pranohet e drejta e borxhit prej 20% në shumën prej 4,184.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore, N.Sh,"I.M.F, Kosova" me seli në Prishtinë (në likuidim) si dhe kamatën ligjore prej 8 % e duke filluar nga data e nxjerrjes së Vendimit me dt.31.03.2015 e deri më tash.

Padisë së tij, paditësi, ia ka bashkangjitur provat : autorizimin e dt.23.07.2020, flete pagesa e AKP-së, me emra dhe me shuma për secilin punëtor, dhe Vendimin e kontestuar të Autoritetit të Likuidimit, PRN008 – 0102 të dt.31.03.2015.

Mirëpo i autorizuari i paditësit, av. N Th nga Prishtina me dt.01.08.2023, i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesën për tërheqjen e padisë por edhe me parashtrësën e dt.30.11.2023, i është drejtuar kësaj gjykate e me të cilin, e ka bërë tërheqjen e padive në 2 (dy) lëndët, C – IV. – 20 – 0041 dhe C – IV. – 20 - 0052 e me arsyetimin se me palën kundërshtare kanë arritur marrëveshje.

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Suprme të Kosovës, (DhPGJSK), e jep pëlqimin për tërheqjen e padisë së paditësit, S H nga Prishtina dhe se padia e tij, konstatohet e tërhequr.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji .

Në nenin 2 par 4 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, parashihet se :''Çdo vendosje, përveç Aktgjykimit, që merret apo lëshohet nga një gjykatë apo koleg, apo një gjyqtar i vetëm i Dhomës së Posaçme, si dhe përfshin, por pa u kufizuar në to, edhe vendimet apo urdhrat''

Në nenin 77 par.1 pika 1 të po këtij Ligji, thuhet se :''Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet: Ligji nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (GZ. Nr.20/22 Shtator 2011, Prishtinë); megjithatë, me kusht që nëse një rast që është në punë në Dhomën e Posaçme në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka përmbyllur procedurat me shkrim dhe gjykimi i atij rasti kërkon vazhdimin e zbatimit të dispozitave procedurale të Ligjit nr. 04/L-033 për

Dhomën e Posaçme, atëherë Dhoma e Posaçme mund të zbatojë ato dispozita procedurale deri në masën e domosdoshme për të siguruar një gjykim të tillë të duhur''.

Në nenin 34 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, parashihet se: *“Paditësi mund ta tërheqë kërkesën apo ankesën e tij në çdo kohë me pajtimin e Dhomës së Posaçme. Me dhënien e pëlqimit të tillë, Dhoma e Posaçme merr parasysh interesin e të gjitha palëve të tjera. Vendimi për dhënien e pëlqimit për tërheqje mund të përfshijë urdhërpagesën për shpenzimet e procedurës nga pala që tërhiqet. Vendimi i tillë nuk e ndalon palën nga parashtrimi i serishëm i kërkesës apo ankesës”.* Në rastin konkret, paditësi, S H edhe pse e ka ushtruar padinë e tij, i njëjti përmes të të autorizuarit të vet, av. N Th nga Prishtina, me parashtrësën e dt.01.08.2023 e ka tërhequr padinë e tij si dhe me parashtrësën e dt.30.11.2023, e ka bërë tërheqjen e padive në 2 (dy) lëndët, C – IV. – 20 – 0041 dhe C – IV. – 20 - 0052 dhe nga gjykata ka kërkuar të jepet pëlqimin për tërheqjen e padive, andaj me arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë gjen se në rastin konkret, janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 34 i Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, e që gjykata të jep pëlqimin për tërheqjen e padisë së paditësit në këtë çështje juridike kontestimore, sepse edhe ky konstatim i tërhequr i padisë së paditësit, nuk është në kundërshtim me interesin e asnjërës nga palët në procedurë.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, dhe nenit 34 par.1 të Ligjit nr.06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).

Shpenzimet gjyqësore

Në pajtim me nenin 62 par.5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme, gjykata ka vendosur secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:285069, 01.12.2023

**Gjykatësi,
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktvendimi nuk mund të parashtrohet ankesë me shkrim por lejohet që pala të paraqes sërish padi/ankesë/kërkesë në bazë të nenit 34 par.1 të Ligjit, nr.04/L – 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK)